

Anija gjigande në kalatën lindore, përpunimi brenda dhe jashtë basenit.

11.11.2011



Anije e tonazhit të madh “Bibi M” është ankoruar mëngjesin e së premtes në orën 10:25 në kalatën 11, në portin e durrësit.

Burimet zyrtare nga Autoriteti Portual Durrës bëjnë me dije se anija me flamur “Turk” do të ngarkojë 46 mijë ton mineral hekuri me destinacion Kinën.

Kondicionuar nga thellësia e basenit, gjysma e ngarkesës do të kryhet në kalatën 11 dhe pjesa tjetër do të realizohet në radën e portit të durrësit, me ndihmën e dy feederave. Përpunimi i anijes do të jetë i ngjashëm me atë të ngarkimit të anijes “Vela” I realizuar me 03 Tetor 2011.

Pjesa e parë e ngarkesës prej 24.0 mijë ton do të përpunohet në kalatën 11, ku dhe thellësia e basenit është më e madhe (11 metra). Kjo ngarkesës pritet të përfundojë Brenda 48 orëve nga ora e nisjes. Proçesi I ngarkimit pritet të nisë në orët e vona të ditës së sotme. ( letrat me portin jane ne rregull vetem pritet qe anija te rregulloje dokumentacionet me institucionet e tjera, prandaj dhe ora e fillimit të proçesit nuk eshte vendosur).

Në ditët në vijim do të vijojë proçesi “Double Banking” (ngarkimi I dyfishtë), duke realizuar ngarkimin e anijes në radë me anë të dy feederave 10 mijë tonëshe.

Ndërkohë sipas burimeve të Drejtorit të Shërbimeve Operacionale, pranë portit të durrësit, i gjithë proçesi “Double Banking” do të zgjasë 7-8 ditë.

Vlen për tu përmendur se I gjithë proçesi do të menaxhohet me sukses në bashkëpunim të plotë nëpërmjet portit të durrësit agjensisë detare Gala dhe kompanisë stevedore ASC, që ka marrë përsipër organizimin e operacionit portual, çka përbën një fazë të re zhvillimi.

Realizimi I këtij proçesi është një arritje shumë e madhe për Portin e Durrësit dhe për eksportet nëpërmjet tij, pasi jemi në fazëne e realizimit të objektivave për të përpunuar anijet e tonazheve të mëdha në portin e durrësit duke arritur në këtë mënyrë “Ekonomi Scale”.

Realizimi me sukses i këtij proçesi rrit pozicionin konkures të portit të Durrësit në rajon dhe e ve Autoritetin Portual përballë realizimit të sfidave të reja që kanë lidhje me rritjen e kapaciteteve përpunuese si dhe zbatimin e projektit të thellimit të basenit dhe kanalit hyrës të tij.

Përfitim të ndërsjelltë ka dhe blerësi, pasi transporti I një sasi kaq të madhe ndryshon çmimin për njësi të produktit duke e ulur në mënyrë të ndjeshme koston e transportit për njësi

